



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 90/13

Nr. i fq. / Br. sh -18-

Data: / Datum 25.04.2013

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

## PROCESVERBAL

**Nga mbledhja e III-të për vitin 2013, e Kuvendit Komunal në Vushtri, mbajtur më 28.03.2013 dhe vazhduar më 04.04.2013**

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:10**. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gjylsime Feka, Habib Mustafa, Habibe Gërzhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërzhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylja, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi dhe Xhemajl Pllana.

Munguan: Gani Imeri dhe Zeqir Hasani, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

Debat lidhur me rendin e ditës:

**Habib Mustafa, kryesues i kuvendit-** propozoi që rendit të ditës, në "të ndryshme" t'i shtohen edhe këto pika: dy propozim-vendime për ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, si dhe Propozim-vendimin për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë për vitin shkollor 2012/2013.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** në emër të Grupit kuvendar të LDK-së paraqiti vërejtje lidhur me propozim-vendimet për ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale, pasi që mungon teksti i neneve që janë propozuar që të hiqen nga rregullorja në fjalë, prandaj kërkoi që gjatë mbledhjes së KK-së përmbajtja e neneve në fjalë t'iu dorëzohet anëtarëve të kuvendit.

**Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë-** paraqiti sqarime shtesë lidhur me dy propozim-vendimet për ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.

**Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, kuvendi i komunës me vota unanime miratoi këtë:**

## REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
2. Shqyrtimi i Draft-strategjisë për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve (shqyrtimi i parë).
3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese, si dhe i punës së kryetarit të komunës dhe ekzekutivit për vitin 2012.
4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Transparencë (shqyrtimi i parë).
5. Shqyrtimi i Informatës për dhënien e tokave bujqësore për shfrytëzim të përkohshëm.
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lirimin nga pagesa të SHMT "Lutfi Musiqi" në Vushtrri për zhvillimin e aktiviteteve sportive.
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit komunal për aksionarë lidhur me menaxhimin e stacionit të autobusëve.
10. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Mitrovicës për lejimin e shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve "Jeton Tërstena" për klubet sportive të Mitrovicës, për zhvillimin e ndeshjeve kampionale pa pagesë.
11. Shqyrtimi i Propozim - listës së rrugëve dhe trotuareve për shtruarje me kubëza betoni për vitin 2013.
12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës Ministrisë të Punëve të Brendshme-Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënin në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për ndërtimin e objektit të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë.
14. Shqyrtimi i Draft-rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij (shqyrtimi i dytë).
15. Të ndryshme:
  - a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.
  - b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale.
  - c. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për vitin shkollor 2012/2013.

### 1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** paraqiti vërejtje lidhur me procesverbalin, pasi që në mbledhjen e kaluar para se të flitet për rendin e ditës, ka pasur një debat, i cili nuk është përfshirë në procesverbal, prandaj kërkoi që i njëjti të përfshihet në procesverbal.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** kërkoi që ai debat të përfshihet në procesverbal, pasi që gjatë diskutimit të tij, S.Kadriu ka thënë se Xhemajl Pllana nuk do të jetë më anëtar i kuvendit sepse nuk ia lejon ligji, prandaj kërkoi sqarime edhe nga S.Kadriu, por edhe nga Xh.Pllana se a ka të drejtë në bazë të ligjit të jetë anëtar i kuvendit, dhe njëkohësisht pyeti se a ka kërkuar Ministria e Tregtisë që Xh.Pllana të

deklarohet se a do të jetë shërbyes civil në Ministrinë e Tregtisë apo anëtar i këtij kuvendi.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** tha se në mbledhjen e kaluar të KK-së ka thënë se kjo që po vendoset për Xhemajl Pllanën, nuk është rasti i vetëm, por ka edhe shumë raste të tjera, jo vetëm në Komunën e Vushtrrisë por edhe në tërë Kosovën, prandaj një gjë që vendoset për Xh.Pllanën duhet të vendoset për të gjithë.

**Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit-** tha se ministria ku punon e ka bërë një kërkesë në formë të ultimatumit që pesë anëtarë të kuvendeve (kryesisht të opozitës) që punojnë në atë ministri duhet të japin dorëheqje, pastaj kemi kërkuar interpretim ligjor, por në vend të interpretimit, na kanë orientuar që të shkojmë në KQZ, kurse interpretimi nga KQZ-ja ka qenë se sipas LVL-së nuk ka konflikt interesi. Po ashtu tha se nuk ka konflikt interesi as në Agjensionin Antikorrupsion ku po e deklarojmë pasurinë, por ministria nuk është tërhequr dhe po kërkon dorëheqjen tonë, mirëpo kërkoi që nëse ligji zbatohet, atëherë le të zbatohet për të gjithë dhe shtoi se ai personalisht e mban një pozitë të thjeshtë në cilësinë e shërbyesit civil. Në vazhdim tha se në mbledhjen e kaluar të KK-së ia ka përmendur emrin drejtori i arsimit, ku e ka akuzuar për shpifje lidhur me donacionin nga "DANIDA", dhe sqaroi se në atë mbledhje të KK-së e ka ngritur shqetësimin pasi që ka dyshuar për keqpërdorim dhe keqmenaxhim të donacionit, prandaj ka kërkuar nga qeveria komunale dhe nga kryetari i komunës që t'i bëhet një auditim rastit në fjalë, por kjo nuk është bërë asnjëherë. Në vazhdim tha se prof.Muharrem Merovci prej që është pensionuar, konkursi për lëndën e Biologjisë nuk është shpallur për 5 apo 6 muajve dhe shtoi se ka paralajmëruar që ai vend po i ruhet personit në fjalë, dhe pikërisht ai njeri është vendosur në atë vend të punës.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** tha se në faqen nr.4 në diskutimin e tij duhet të përfshihet edhe fjalja e tij "pasqyrat financiare sërish mund të quhen skandaloze".

**Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim-** tha se donacioni në fjalë është menaxhuar nga "DANIDA" e jo nga shkolla, dhe pasi që është informuar drejtori i shkollës ka kërkuar që të ngrit padi gjyqësore. Kurse konkursi nuk është hapur deri në shtator dhe drejtorit i ka kaluar afati i kontratës në cilësinë e drejtorit, prandaj në bazë të ligjit të ri të arsimit profesional nuk ka të drejtë të jetë drejtor i shkollave të mesme profesionale, dhe për këtë arsye Drejtoria për Arsim e ka sistemuar në gjimnaz.

***Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, me vërejtjet dhe sugjerimet e S.Kadriut dhe R.Ramaj.***

## **2. Shqyrtimi i Draft-strategjisë për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve (shqyrtimi i parë).**

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** tha se draft-strategjia në fjalë i plotëson kushtet për të shkuar në diskutim publik dhe shtoi se shpreson se ato çka janë shkruar në të, do të realizohen në të ardhmen. Në vazhdim tha se nuk kemi pasur strategji, duke shtuar se edhe kuvendi i komunës e ka përmbyllur mbledhjen e fundit të KK-së me peticione të qytetarëve, e po ashtu edhe kemi filluar këtë vit me peticion të qytetarëve, kurse në faqen nr. 10, pika 3 "mediat e shkruara", tha se nuk pajtohet me këtë vlerësim, sepse nuk është real dhe i kënaqshëm pasi që ngjarjet, aktivitetet dhe puna që bëhet në komunë dhe kuvend nuk mbulohet sa duhet, sepse ajo mbulohet vetëm në mënyrë sporadike, duke pasur parasysh mungesën e korrespondentëve të rregullt. Në vazhdim tha se mjetet tona të informimit janë të politizuara dhe nuk janë plotësisht të pavarura, kurse në disa raste korrespondentët janë shantazhuar dhe nuk kanë informuar siç duhet, prandaj për të ardhmen kërkoi që korrespondentët të kenë hapësirë të shkruajnë sipas vlerësimit të tyre.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** tha se çështja që po diskutohet është me shumë rëndësi për një shoqëri demokratike, por seriozitetin tonë gjatë trajtimit të kësaj teme duhet ta tregojmë edhe gjatë diskutimit publik.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** tha se draft-strategjia në fjalë është shumë e rëndësishme dhe shtoi se ka hapësirë për të bërë përmirësime të dukshme në lidhje me informimin, komunikimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, pasi që nga e kaluara është kuptuar se pjesëmarrja e qytetarëve në diskutime publike ka qenë shumë e vogël. Pastaj në faqen nr. 9 të "vlerësimi i gjendjes aktuale", në rastin e paraqitjes së vlerësimit nga GAP-i, tha se në fund të faqes është dashtë të vendoset një fusnotë ku do të shënohej se nga cili burim është cituar.

**Gjylsime Feka, anëtare e kuvendit-** duke iu referuar diskutimit të Q.Azemit për çështjen e shantazhimit të korrespondentëve, tha se duhet bërë ndjekje penale për të gjithë ata që vazhdojnë të përdorin mediat dhe faqet e ndryshme sociale për të shpifur.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** tha se duhet përshëndetur draft-strategjinë në fjalë, pasi që për herë të parë kemi një dokument që planifikon punën e informimit, sepse çështja e informimit me qytetarë për çdo qeveri duhet të jetë me prioritet mbi prioritetet. Pastaj tha se Zyra për Informim në Komunën e Vushtrrisë e ka kryer detyrën në nivelin më të mirë dhe për këtë arsye ka qenë e shpërblyer dy herë radhazi nga USAID-i. Në fund tha se korrespondentët për punën e tyre i marrin instruksionet nga redaksitë e veta, dhe shtoi se korrespondentët që nuk janë pjesë e administratës së komunës janë të pavarur në shprehjen e mendimit të tyre.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se është hera e parë që Komuna e Vushtrrisë ka hartuar Strategji për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve, të cilën edhe e vlerësoi si një dokument shumë të rëndësishëm.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Ipet në diskutim publik Draft-Strategjia për Informim, Komunikim, dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.***

***Diskutimi publik fillon nga data 29.03.2013 dhe zgjatë deri më 16.04.2013.***

**3. Shqyrtimi i Raportit për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese, si dhe i punës së kryetarit të komunës dhe ekzekutivit për vitin 2012.**

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** tha se raporti në fjalë përmban një kuantum me informacione të shumta për aktivitetet e komunës, të cilat rezultuan me një mori projektesh të realizuara, që kryesisht ishin të orientuara në infrastrukturën fizike. Pastaj tha se ka nuanca përparimesh në strategjinë e përndarjes së flukseve financiare hyrëse si outputet aktive afatgjate të komunës. Në vazhdim tha se raporti në fjalë nuk ofron disa informacione relevante, siç janë: informacione për situatën ekonomike financiare të Komunës së Vushtrrisë; indikatorët e duhur matës të performancës së komunës, veçanërisht drejt përmirësimit të ambientit ndërmarrës në Komunën e Vushtrrisë, si dhe nuk ofron asnjë indikator matës rreth zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të komunës; raporti ofron informacionin e performimit pozitiv të komunës rreth lehtësimit të procedurave për regjistrimin e biznesit, mirëpo raporti nuk ofron edhe një mori çështjesh rreth situatës ekonomiko-financiare; asnjë indikator matës të raportuar për situatën ekonomike as të komunës si administratë; as për ekonominë familjare dhe as për komunitetin e biznesit; asnjë të dhënë për investimet e huaja në bizneset e komunës; asnjë informatë për investimet në titujt financiar të ndërmarrjeve në Vushtri; asnjë informatë për kreditë e akorduara nga bankat komerciale për investimet në komunitetin e biznesit; asnjë indikator matës të nxitjes së zhvillimit ekonomik; në raport përshkruhet numri i

bizneseve të regjistruara dhe i atyre të çregjistruara, por mungon një analizë profesionale për shkaqet dhe dështimet e bizneseve; raporti nuk ofron asnjë tregues relevant matës të performimit të komunës në arsim, shëndetësi, mirëqenie sociale, përderisa në bujqësi raporti ka disa indikatorë matës më të shprehur; raporti ofron indikacione pa analiza adekuate dhe me gabime të caktuara për implementimin e projekteve, të cilat nuk flasin për punën e kryetarit. Pastaj lidhur me “objektivat e realizuara”, tha se nëntë prej tyre nuk janë objektiva, por janë projekte. Po ashtu tha se duhet riformuluar “objektivat e realizuara pjesërisht”, kurse te “aktivitetet e kryetarit të komunës” edhe pse ka pasur takime, nuk është cekur takimi i kryetarit të komunës me shoqatën e afaristëve, me ndonjë biznes të suksesshëm; asnjë takim që ka pasur kryetari i komunës me fermerët e patates. Në fund tha se objektivat e paraqitura tek shëndetësia dhe përkujdesja sociale janë të pamatshme, kurse në faqen 36, në tabelar janë paraqitur përqindjet të cilat janë gabim në tërësi. Te inspekcioni disa të dhëna të paraqitura, duhet të jepen përmes tabelarit, si dhe nuk janë ndarë njësitë fizike prej atyre financiare.

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se Zyra për Barazi Gjinore është shkrirë dhe roli i saj ka humbur, pasi që është futur tek Njësia për të drejtat e njeriut, mirëpo ajo zyrë është dashtë të paraqitet e veçantë. Kurse lidhur me arsimin, te “projektet kapitale” tha se nuk është paraqitur në raport ashtu siç e ka peshën dhe shtoi se ka qenë një projekt i rëndësishëm (që nga viti 2008) për heqjen e patosave të vjetër nëpër shkolla, mirëpo mjerisht ai projekt nuk është kryer, pasi që ka me dhjetëra shkolla që kanë patosa të vjetër. Pastaj tha se ka shumë shkolla që janë në gjendje alarmante lidhur me infrastrukturën e tyre, ndër to janë fshatrat: Maxhunaj, Pestovë, Stanoc, Karaçë, Stroc, Beçuk dhe Gllavotin. Po ashtu është dashtë të paraqiten edhe disa objektiva që nuk janë përmbushur, siç është emërtimi i shkollave, pasi që mbi 6 shkolla janë pa emra, dhe shtoi se ka pas edhe ndërrime të emrave të shkollave që nuk kanë pas bazë ligjore. Në vazhdim lidhur me mësimin praktik te shkollat profesionale, tha se mungojnë kabinetet dhe mungon punësoria, mirëpo edhe pse mungojnë nuk përmenden tek objektiva në këtë raport, sepse për mësimin praktik plani realizohet vetëm 30 %. Tutje tha se është brengosës testi i maturës, pasi që ka rënie të kalueshmërisë në shkollat e mesme, kurse në vazhdim tha se është absurd për arsimin ku në shkollën e mesme pranohet si pastrues profesori i diplomuar Bedri Bllata, prandaj është dashtë drejtori i arsimit t’ia gjej një vend tjetër të punës. Në fund lidhur me punën praktike, tha se në fshatin Vërmicë është një pemishte e bukur dhe kjo pemishte nuk është duke u ruajtur, meqë 70 % e saj ka filluar të thahet e në të cilën është dashtë të mbahet praktika.

**Pabazit Pllana, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, kërkoi nga Drejtoria për Inspektime që të gjitha lokalet ku punohet me palë dhe përgatitet ushqimi, të verifikohet posedimi i librezave sanitare në vendet e punës. Pastaj lidhur me çështjen e furnizimit me barëra nga lista esenciale tha se nuk kemi një raport krahasues sesi ka qenë vjet dhe parvjet, e si është sivjet, pasi që gjendja është më e rëndë. Në vazhdim tha se një problem që në Kosovë ka zënë një vend të rëndësishëm është problemi me insulinë dhe shtoi se Vushtrria i ka 400 raste të cilët janë të varur prej insulinës dhe kanë mbetur pa insulinë, prandaj ky problem ka marrë konotacion shumë të rëndë, dhe siç duket do të ketë pasoja të rënda. Tutje tha se pacientët në nivelin e komunës të cilët janë në fazën terminale (që janë në fazën e rëndë para vdekjes) shtohen për çdo ditë tumoret, por edhe sëmundjet tjera që lidhen me dializë dhe me anemi të rënda, prandaj rekomandoi që niveli primar ta bëjë një punë më të mirë dhe të organizojë e t’i përcjellë në shtëpi këta pacientë. Mandej tha se problemi tjetër që rëndon shumë është çështja e shëndetit mental, pasi që për çrregullimet e rënda mentale të cilat kanë mbetur pa u menaxhuar dhe pa u mbikëqyrur, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale duhet të koordinojë punën me ekspertët për trajtimin e rasteve në fjalë. Po ashtu tha se shërbimi i vaksinimit është baza ku zhvillohet imuniteti i njeriut dhe krijon

parakushte për të qenë i shëndoshë dhe t'i shërbejë kësaj shoqërie. Në fund tha se Drejtoria për Shëndetësi duhet ta furnizojë QKMF-në me inhalator dhe t'i trajtojë pacientët që kanë nevojë.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** tha se raporti në fjalë është një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm. Pastaj tha se është dhënë vërejtje edhe nga shefi i Grupit kuvendar i LDK-së për planin e punës që e ka paraqitur kryetari i komunës në vitin 2012, sepse ky plan më shumë përmban synime dhe qëllime të cilat kryetari dëshiron t'i arrijë komuna, por pak përmban objektiva të matshme me tregues të matshëm të cilët mundësojnë që tash kur raportohet të dihet, dhe përmendi si shembull konkret arsimin, ku në shkollën teknike nuk kanë kaluar 85 %, dhe kjo është gjendje alarmante, prandaj do të ishte mirë që kryetari i komunës në planin e tij të punës të thotë se gjendja e suksesit në 2011 ka qenë kjo, kurse në 2012 planifikojmë ta ngrisim suksesin nga 50 % në 57 % apo 60 % dhe të shihet se a është arritur përmbushja e kësaj objektive, ose në shëndetësi me u ndërlidh me numrin e pacientëve, me numrin e rasteve sociale, pra me qenë parametra të matshëm. Pastaj lidhur me çështjen e prokurimit tha se për disa projekte thuhet "jo, nuk është iniciuar nga njësia e kërkesës", prandaj është dashtë të sqarohet pse nuk është iniciuar. Në fund tha se nga raporti shihet se në vitet 2011-2012 afër 200 hektarë janë djegur me pyje, kurse në vitin 2012 thuhet se janë pyllëzuar 35 hektarë.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar raportit në fjalë, tha se është shqetësuese kualiteti i punëve të kryera, pasi që shumë punë që po kryhen, po shkatërrohen menjëherë dhe a mungon kjo tek kontrolli nga organet mbikëqyrëse apo te mungesa e instituteve shtetërore që kontrollojnë kualitetet që nga materialet ndërtimore e deri te prodhimet tjera, prandaj në këtë drejtim kemi përgjegjësi, sepse çdo punë bëhet për qytetarët dhe duhet të kemi kontroll të kualiteteve të ndërtimit. Pastaj për lëmin e arsimit dhe shëndetësisë kërkoi që me ribalancë që në fillimin e vitit shkollor të bëhet kontrollimi sistematik shëndetësor i nxënësve nëpër të gjitha shkollat. Po ashtu kërkoi që të mos bëhet subvencionimi apo projektet në baza të ngushta partiake, prandaj adresimi i projekteve të jetë në tërë territorin e komunës dhe të bëhet zhvillimi harmonik i tërë territorit të komunës. Në vazhdim kërkoi sqarime në faqe nr. 20 kur flitet për përfituesin e projektit nr. 1 të paraqitur në tabelë. Pastaj një çështje që e karakterizon komunën është shuarja e bizneseve, ku brenda këtij viti janë shuar 89 biznese, prandaj duhet analizuar pse po shuhet bizneset, në vend që të rriten.

**Gjylsime Feka, anëtare e kuvendit-** tha se raporti në fjalë është gjithëpërfshirës, mjaft përmbajtësor dhe i hartuar konform Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. Po ashtu tha se është një pasqyrë reale e gjithë asaj çka është planifikuar dhe shpenzuar. Mandej tha se shifra e realizimit total të vitit prej 96.43 % flet për një përkushtim, angazhim dhe qasje serioze në realizimin e projekteve dhe punëve të parashtruara e posaçërisht në implementimin e të gjitha vendimeve që janë aprovuar në kuvendin e komunës. Në fund tha se raporti në fjalë në hollësi përmes tabelave dhe shifrave krahasuese paraqet një pasqyrë të qartë të punës së kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** në emër të Grupit kuvendar të PDK-së tha se raporti në fjalë është përgatitur konform Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të Komunës së Vushtrrisë. Gjithashtu tha se në bazë të raportit shihet se janë plotësuar shumica e objektivave të planifikuara, janë realizuar projekte të mëdha dhe të vogla në harmoni me planifikimin e buxhetit. Pastaj tha se Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka bërë një punë të mirë lidhur me realizimin e të hyrave të tatimit në pronë dhe të hyrat nga taksa komunale për biznese. Po ashtu Drejtoria për Ekonomi dhe Bujqësi ka lehtësuar procedurat e regjistrimit të bizneseve. Mandej tha se fal Ministrisë së Bujqësisë dhe organizatave tjera ndërkombëtare, është duke shënuar rritje nga viti në vit subvencionimi i bujqësisë në Komunën e Vushtrrisë. Kurse Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë

një punë të mirë në vitin e kaluar duke ndryshuar gjendjen për të mirë, duke u përkujdesur për gjelbërimin nëpër pjesë të ndryshme të qytetit, si dhe janë realizuar shumë projekte nga kjo drejtori siç është shtrimi i rrugëve me kubëza, është ndërtuar rrjeti i kanalizimit dhe i ujësjellësit. Në vazhdim përmendi edhe sukseset e drejtorive tjera të qeverisë lokale. Në fund tha se Grupi kuvendar i PDK-së vlerëson lartë punën e kryetarit të komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2012.

**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit-** tha se e përkrah raportin në fjalë, por tha se raportit i mungon pasqyrimi i ndihmave të ndryshme dhe disa aktiviteteve nga organizata të ndryshme turke.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** duke iu referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit lidhur me raportin në fjalë, paraqiti këto sqarime: fillimisht tha se kryetari i komunës e ka obligim që mjetet financiare të cilat i aprovon kuvendi i komunës dhe i shpërndan nëpër projekte, t'i realizojë ashtu siç aprovohen. Pastaj tha se është pozitive që projektet e planifikuara në vitin 2011 për vitin 2012 kryesisht janë realizuar, duke shtuar se kanë mbetur edhe disa projekte të porealizuara. Po ashtu tha se me mjetet e bartura nga viti 2011 në vitin 2012 janë kryer të gjitha projektet që janë menduar të përfundohen. Kurse lidhur me cilësinë e realizimit të projekteve tha se asnjëherë asnjë kryetar i komunës nuk është i kënaqur me nivelin e mjaftueshëm të standardeve të realizimit të projekteve, por shtoi se aktualisht janë duke u realizuar projektet me standarde shumë më mirë sesa në të kaluarën. Në vazhdim tha se edhe përkundër disproporcionit në mes të të hyrave të planifikuara dhe atyre të investuara, megjithatë janë realizuar shumë projekte fal edhe investimeve nga Qeveria e Kosovës. Ndërsa hartimi i planit zhvillimor urban dhe tri planet rregulluese i kanë ndihmuar Komunës së Vushtrrisë për dhënien e një fizionomie zhvillimit të infrastrukturës. Sa i përket zhvillimit ekonomik tha se është shumë pozitive që vitin e kaluar është riaktivizuar fabrika "Llamkos", po ashtu është fat i madh për Komunën e Vushtrrisë që ka shumë tokë bujqësore dhe ka filluar që të punohet, dhe shtoi se qeveria komunale është duke i stimuluar bujqit në forma të ndryshme. Pastaj tha se si kryetar i komunës gjatë qeverisjes së tij, ka bërë dhe është duke bërë përpjekje maksimale për ta luftuar nepotizmin, duke shtuar se ka shumë drejtorë të shkollave që nuk janë të PDK-së. Në fund tha se ndarja e subvencioneve është bërë në mënyrë shumë transparente dhe në bashkëpunim me kuvendin e komunës.

**Safet Idrizi, drejtor i DSHMS-së-** lidhur me vërejtjet e paraqitura për Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në raportin në fjalë paraqiti sqarime shtesë, ku ndër të tjera sqaroi se tërë raporti i drejtorisë në fjalë nuk ka mundur të përfshihet në tërësi në raportin e kryetarit të komunës. Po ashtu sqaroi se furnizimi me insulinë është kompetencë e Divizionit farmaceutik të Ministrisë së Shëndetësisë, kurse lejen për import e ka AKPM-ja, dhe e njëjta vlen edhe për furnizimin me barëra. Në fund tha se vaksinimi është i kënaqshëm pasi që është realizuar sipas standardeve dhe rekomandimeve të Institutit Kombëtar për Shëndet Publik.

#### **4. Shqyrtimi i Draft-rregullores për Transparencë (shqyrtimi i parë).**

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** tha se draft-rregullorja në fjalë është mjaft e rëndësishme dhe së bashku me Strategjinë për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje të Qytetarëve kontribuojnë shumë në transparencë dhe transparenca ndikon shumë në besueshmërinë e qytetarëve në pushtetin e komunës.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Ipet në diskutim publik Draft-Rregullorja për Transparencë të Komunës së Vushtrrisë.***

***Diskutimi publik fillon nga data 29.03.2013 dhe zgjatë deri më 16.04.2013.***

## **5. Shqyrtimi i Informatës për dhënien e tokave bujqësore për shfrytëzim të përkohshëm.**

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** lidhur me informatën në fjalë, tha se ka nevojë që anëtarët e kuvendit të komunës të kenë disa sqarime shtesë rreth kësaj çështjeje. Pastaj tha se shumica e shprehur në kuptimin e interesit të komunës është rreth 13.000 € për tërë këtë kohë pa e ndarë sipas viteve. Po ashtu tha se nuk i njohim personat që kanë marrë tokat bujqësore në shfrytëzim, por shihet se i njëjti person ka marrë rreth 30-40 hektarë tokë dhe shtoi se nuk ka të keqe nëse është ndonjë biznesmen i mirëfilltë, i cili e shfrytëzon atë pronë për qëllime bujqësore. Mandej tha se me këtë formë të dhënies së tokave bujqësore, sikur po legalizohen disa veprime të paligjshme që janë bërë më herët e që është uzurpimi i pronave. Në fund tha se duhet të dihet se të gjitha këto prona a kanë kaluar nëpër procesin transparent të tenderimit, si dhe a janë kontratat në bazë të tenderit.

**Nasuf Aliu, drejtor i DEBZHR-së-** tha se informata e këtij lloji është paraqitur për herë të parë, ku është bërë përpjekje që të përfshihet gjithçka, duke filluar nga rastet e para. Mandej duke iu referuar vërejtjeve dhe pyetjeve të M.Shabanit, tha se ka qenë e hapur ftesa për ofertë. Po ashtu tha se nuk ka qenë kriter që një person të mos ketë të drejtë të marrë më shumë se një parcelë në shfrytëzim të përkohshëm të tokave bujqësore. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me informatën në fjalë.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** sqaroi se katër rastet e para (të paraqitura në informatën në fjalë) janë dhënë me vendim të KK-së për zhvillim të bizneseve dhe nuk janë dhënë sikur rastet tjera, të cilat janë dhënë për shfrytëzim dhe punim të tokës bujqësore, dhe shtoi se është hera e parë që Komuna e Vushtrrisë fiton prej pronës së vet, prej aseteve të veta që i ka në pronësi nga prona e paluajtshme. Kurse sa i përket uzurpimit të pronave publike, tha se uzurpimet më të mëdha janë bërë para luftës dhe menjëherë pas luftës në Kosovë.

## **6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim me kompensim të pronës së paluajtshme të komunës.**

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, propozoi që të shtohet një nen i ri ku duhet të thuhet se të gjitha këto prona që jepen për shfrytëzim, në momentin e duhur që i paraqitet nevoja komunës për një projekt zhvillimor, atëherë komuna e mban të drejtën për ta shkëputur kontratën.

**Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë-** duke iu referuar diskutimit të M.Shabanit, tha se ky vendim merret vetëm në parim, pasi që ky është vendim paraprak sa për t'u dhënë leja për zhvillimin e procedurave të ankandit dhe formimit të komisionit për vlerësim të ofertave, prandaj me këtë vendim këto prona nuk jepen në shfrytëzim.

**Nasuf Aliu, drejtor i DEBZHR-së-** tha se lista e pronave është hartuar si rezultat i një pune të përbashkët nga komisioni komunal, USAID-i dhe organet tjera ndërsektoriale të komunës. Pastaj njoftoi se është edhe një kontraktor i ri, prandaj kërkoi që nga kjo listë të fshihet Stanoci i Poshtëm, me numër rendor 15, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota "për", të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:**

***Me qëllim të interesit publik të komunës, lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër me kompensim e pronave të paluajtshme të komunës të listuara nga nr. rendor 1 deri 158, të bashkangjitura në shtojë të këtij vendimi, personave fizik dhe juridik në afat prej 1 deri 15 vite.***



**Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër do të zbatohet përmes konkurrencës së hapur – ankandet publike.**

**7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale.**

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** tha se Grupi kuvendar i PDK-së propozon për anëtar të këtij komisioni Hajrulla Mulin.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** tha se Grupi kuvendar i AAK-së është kundër një komisioni të tillë të njëanshëm dhe kryesisht një partiak, i cili nuk do të jetë në gjendje t'i zbatojë obligimet, siç janë: parimi i transparencës, trajtimi i barabartë i palëve, vlerën unike të pronës, si dhe ruajtjen, prandaj duke pasur këto dyshime nuk dëshirojnë të jenë pjesë e këtij komisioni.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** tha se Lëvizja për Bashkim mendon se formimi i këtij komisioni është njëpartiak, prandaj me një komision të tillë njëpartiak nuk mund të jemi transparentë, prandaj është kundër këtij komisioni.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** tha se edhe Grupi kuvendar i LDK-së tërhiqet nga përbërja e këtij komisioni me arsyetimin e njëjtë sikur të dy parafolësve.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** tha se Grupi kuvendar i PDK-së e mbështet formimin e komisionit, pasi që është interes i komunës që këto prona të jepen në shfrytëzim dhe është interes i qytetarëve që këto parcela të shfrytëzohen, dhe nga to të krijohen të hyra. Pastaj tha se pasi që opozita nuk dëshiron të jetë pjesë e këtij komisioni, propozoi për anëtar të komisionit edhe Esat Bekën.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 15 vota “për”, 16 “kundër” vendosi me sa vijon:  
Nuk aprovohet propozim-vendimi në fjalë.**

**Diskutimet pas votimit të kësaj pike të rendit të ditës:**

**Nasuf Aliu, drejtor i DEBZHR-së-** kërkoi mirëkuptimin dhe mbështetjen e anëtarëve të kuvendit për t'u aprovuar formimi i komisionit në fjalë.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se është e rregulluar me ligj që ky komision të jetë i përbërë nga 7 anëtarë, 3 anëtarë nga qeveria komunale, 1 anëtar nga shoqëria civile, dhe 3 anëtarë nga kuvendi i komunës. Gjithashtu propozoi që të ketë konsultime në mes të shefave të grupeve kuvendare për të arritur një marrëveshje për çështjen në fjalë.

**Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë-** sqaroi se për një çështje të caktuar nuk mund të votohet më tepër se njëherë.

**Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës Ligjore-** tha se në nenin 8.2 të Ligjit mbi Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme thuhet: “kryetari i komunës propozon 3 anëtarë të ekzekutivit të komunës, kuvendi i komunës propozon 3 anëtarë nga subjekte të ndryshme politike të përfaqësuara në kuvend”, prandaj shtoi se nuk është në rregull nëse komisioni në fjalë përbëhet nga përfaqësues të vetëm një subjekti politik, prandaj kërkoi që të respektohen procedurat ligjore.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** tha se pas konsultimeve shtesë, Grupi kuvendar i PDK-së propozon për anëtarë të komisionit: Hajrulla Mulin dhe Tasim Gubetin.

**Sabri Ferati, anëtar i kuvendit-** propozoi që zyrtari i Sekretarisë së Kuvendit i cili po numëron votat të ndërrohet, pasi që nuk është hera e parë që nuk po bën numërim real të votave. Pastaj e përkrahu që shefat e grupeve kuvendare të konsultohen mes vete dhe të arrijnë një marrëveshje, sepse përfundoi votimi për këtë pikë të rendit të ditës.

**Ferit Idrizi, anëtar i kuvendit-** kërkoi që të ketë konsultime në mes të shefave të grupeve kuvendare për të arritur një marrëveshje për çështjen në fjalë.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** propozoi që për mbledhjen e radhës së KK-së të takohen shefat e grupeve kuvendare dhe të arrijnë një marrëveshje për çështjen në fjalë.

#### **8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lirimin nga pagesa të SHMT “Lutfi Musiqi” në Vushtrri për zhvillimin e aktiviteteve sportive.**

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport duhet ta bëjë një marrëveshje me drejtorinë e shkollës për mënyrën e shfrytëzimit të palestrës.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

*Me këtë vendim lirohet nga pagesa e tarifës komunale SHMT “Lutfi Musiqi” në Vushtrri për shfrytëzimin e palestrës sportive “Jeton Tërstena”.*

*Lirimi nga pagesa bëhet për një termin brenda javës, kur nuk pengohen aktivitetet e klubeve të komunës, kurse si kompensim SHMT “Lutfi Musiqi” i ofron objektit të palestrës mirëmbajtjen e instalimit teknik dhe ujësjellësit.*

#### **9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit komunal për aksionarë lidhur me menaxhimin e stacionit të autobusëve.**

**Sami Istrefi, drejtor i DSHP-së-** paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-** në emër të Grupit kuvendar të AAK-së tha se e përkrahin formimin e komisionit dhe nga AAK-ja e propozoi për anëtar të komisionit Sabri Feratin.

**Naile Osmani, anëtare e kuvendit-** në emër të Grupit kuvendar të PDK-së propozoi për anëtarë të komisionit Gjylsime Fekën dhe Islam Krasniqin.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**1.1. Me këtë vendim formohet komisioni komunal i aksionarëve në këtë përbërje:**

**1.1.1. Islam Latifi, zyrtar nga Drejtoria për Shërbime Publike;**

**1.1.2. Gjylsime Feka, anëtare e kuvendit;**

**1.1.3. Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit.**

**Komisioni komunal i aksionarëve vepron në emër të komunës dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Ndërmarrje Publike, si dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.**

**Pas aprovimit të vendimit, ku u votua veç e veç për secilin kandidat për komision, e mori fjalën:**

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** tha se nëse dëshirohet pjesëmarrje shumëpartiake duhet vepruar ndryshe, sepse këtu po dominon vetëm mbivotimi, prandaj kërkoi nga kryesuesi dhe partia në pushtet që të mos kërkojnë për të qenë pjesëmarrës prapa vendimeve të kundërligjshme, dhe shtoi se në rastin konkret nuk dëshirojnë më të jenë kooperues rreth këtyre çështjeve.

**Sqarim: Pas aprovimit të vendimit për formimin e komisionit komunal të aksionarëve, në shenjë pakënaqësie, Grupi kuvendar i AAK-së e ka lëshuar mbledhjen e KK-së.**

**10. Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Mitrovicës për lejimin e shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve “Jeton Tërstena” për klubet sportive të Mitrovicës për zhvillimin e ndeshjeve kampionale pa pagesë.**

**Qamil Sahiti, drejtor i DKRS-së-** paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me kërkesën në fjalë.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** lidhur me kërkesën në fjalë tha se është e nevojshme të ketë një marrëveshje më afatgjate, në mënyrë që të ndihmuarit përmes lejimit të shfrytëzimit të palestrës së sporteve, të jetë reciprok në mes të dy komunave kur paraqitet nevoja.

**Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë-** tha se është mirë që në marrëveshje të potencohet se për takimet sportive që zhvillohen nga klubet e tyre, atëherë të merren përsipër që të gjitha dëmet t'i paguajë Komuna e Mitrovicës.

**Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit-** pyeti se kush do t'i shfrytëzojë të hollat e biletave që shiten për takimet sportive?

**Qamil Sahiti, drejtor i DKRS-së-** tha se nuk i merr përsipër dëmet asnjëra komunë, por i merr përsipër organizatori i lojës.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar kërkesës në fjalë, paraqiti vërejtje pasi që kërkesën e ka drejtuar shefi i sektorit për sport, sepse është dashtë që (drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Mitrovicës) kërkesën ta drejtoë përmes kryetarit të Komunës së Mitrovicës për kryetarin e Komunës së Vushtrrisë. Po ashtu tha se duhet të bëhet një marrëveshje dhe të merr dikush obligime për këtë çështje.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota “për”, të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

***Me këtë vendim lejohet shfrytëzimi i palestrës së sporteve në Vushtri nga klubet sportive të Mitrovicës për zhvillimin e ndeshjeve kampionale pa pagesë.***

***Lejimi i shfrytëzimit të palestrës së sporteve në Vushtri sipas nenit paraprak, bëhet deri në finalizimin e renovimit të Palestrës Sportive “Minatori” në Mitrovicë.***

***Në rast të dëmtimit eventual të inventarit të palestrës gjatë zhvillimit të ndeshjeve sportive, organizatori do të kompensojë të gjitha shpenzimet për riparimin e dëmeve të shkaktuara.***

**11. Shqyrtimi i Propozim - listës së rrugëve dhe trotuareve për shtruarje me kubëza betoni për vitin 2013.**

**Sami Istrefi, drejtor i DSHP-së-** pasi që paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-listën në fjalë. Po ashtu propozoi që listës në fjalë t'i bashkëngjiten edhe këto rrugë për shtruarje në kubëza: “Milaim Salihu”; “Te Podrança”- te lagjja “Jonuzi” dhe fsh. Mihaliq lagjja “Syla”. Kurse për shtrimin e trotuareve më kubëza propozoi: fsh. Stroc – në shf. “Liria” dhe fsh. Maxhunaj.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se nga lista në fjalë hyjnë në prioritet ato rrugë për të cilat komuniteti participon më shpejt dhe më shumë.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** tha se Grupi kuvendar i LDK-së (kur është bërë hartimi i projekt-buxhetit për vitin 2013, si dokument kryesor i politikës fiskale) ka kërkuar që aty të emërtohen të gjitha rrugët me kubëza dhe rrugët me participim, por një kërkesë të tillë nuk e kishte pranuar koalicioni qeverisës, pasi që partisë në pushtet iu ka nevojitur kohë për të rregulluar listën me emërtime ashtu siç i konvenon, prandaj Grupi kuvendar i LDK-së nuk do të merr pjesë as në diskutim, as në votim, por as në seancë të KK-së.

**Esat Beka, anëtar i kuvendit-** propozoi që të futet në listën në fjalë edhe pjesa e rrugëve tek hyrja e stadiumit të qytetit.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 17 vota “për”, vendosi me sa vijon:**

**Aprovohet shtruarja e rrugëve dhe trotuareve me kubëza betoni për vitin 2013.**

**1.1. Rrugët që do të shtrohen me kubëza betoni janë:**

**“2 Maji” Segmenti 1 dhe 2; “Ruzhdi Hyseni” (te mulliri); “Jeton Tërstena” segmenti 1,2,3,4; “Lutfi Musiqi” segment; “Faik Konica”; “Vëllezërit Frashëri”; “Hajzer Jashari”; “Haxhi Zeka” magjistrale-segment; “Zahir Pajaziti”; “Avni Saraçi”; “Hakif Zejnullahu” segmenti 1 dhe 2; “Kongresi i Manastirit” te shkolla “Ali Kelmendi”; “Shotë Galica” magjistrale-segmenti 1,2,3; “Bastri Beqiri”; “17 Qershori” segment; “Bahri Kuçi” segmenti 1, 2, 3, 4; “Skënderbeu” segmenti 1 dhe 2; “Izet Zejnullahu” kubëza, kanalizim dhe ujësjellës; “Shalës” segmenti 1, 2 dhe 3; fsh. Begaj segmenti 1 dhe 2; fsh. Bukosh segmenti 1 dhe 2; fsh. Shtitaricë segmenti 1, 2, 3; fsh. Gojbulë; fsh. Mihaliq lagjja “Syla”; “Faruk Beqiri” segmenti 1; “Drenica” segment; te Musa Balaj; fsh. Dobërllukë segment; fsh. Stanoc lagj. “Shala”; fsh. Nadakoc lagj. “Sahiti”; “Isak Halili” segment; “Edmond Hoxha”; “Faik Konica” te Shkolla e Mesme Teknike; “Milaim Salihu”; dhe Te Podranqa te lagjja “Jonuzi”.**

**1.2. Trotuaret që do të shtrohen me kubëza betoni janë:**

**“Ajet Gërguri” te ish-Poleti; Te ura e Sitnicës-Stacioni i Trenit – Bukosh; “2 Maji” deri te Njësia e Zjarrfiksave; “17 Qershori”; fsh. Begaj- vazhdim; fsh. Shtitaricë Hekurudhë-shkollë; “Bedri Pejani”; fsh. Bukosh, te shkolla para oborrit; “Lumni Surdulli”; “Isak Halili”; “Bahri Kuçi”; “Hazir Gjaka”; “Vëllezërit Gërvalla”; “Jeton Tërstena”; “Faruk Beqiri”; “Hakif Zejnullahu”; fsh. Lum Madh; në fsh. Dobërllukë “te qeshmja”; fsh. Smrekonicë te Përmendorja e Xhevat Jusufit; fsh. Stroc – në shf. “Liria”; fsh. Maxhunaj.**

**Përparësi në shtrimin e trotuareve dhe rrugëve me kubëza sipas nenit paraprak do të kenë ato komunitete që participojnë në përqindje më të madhe.**

**Mbledhja e KK-së në mungesë të kuorumit i ndërpreu punimet në orën 14:20.**

### **Vazhdimi i mbledhjes së KK-së më 04.04.2013**

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën 10:10.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Gjylsime Feka, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabri Ferati, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Syla, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlorë Qirezi dhe Xhemajl Pllana.

Munguan: Arta Ismajli, Sabit Kadriu dhe Zeqir Hasani, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Vazhdimin e mbledhjes e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe filloi me vazhdimin e këtyre pikave të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës Ministrisë së Punëve të Brendshme–Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për ndërtimin e objektit të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë.

14. Shqyrtimi i Draft-rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij (Shqyrtimi i dytë).

15. Të ndryshme:

a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale (Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale).

b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale (Drejtoria për Buxhet dhe Financa).

c. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë për vitin shkollor 2012/2013.

ç. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

U diskutuan bashkërisht këto dy pika të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës Ministrisë së Punëve të Brendshme–Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për ndërtimin e objektit të Gjykatës Komunale të Vushtrrisë.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** paraqiti sqarimet shtesë lidhur me dy propozim-vendimet në fjalë.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** tha se çështjet për të cilat po diskutohet janë me interes të përgjithshëm të vendit, si dhe për interes të institucioneve shtetërore, qoftë Ministrisë së Punëve të Brendshme, qoftë Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Pastaj tha se është në interesin e komunës sikur të bëhej një këmbim të Vicianumi, sepse edhe ajo pjesë është pjesë e institucioneve të Kosovës. Po ashtu shprehu shqetësimin për mënyrën sesi është vepruar me shumë parcela tjera në komunë e që kanë mundur t'ju jepen institucioneve komunale, por ata i kanë marrë privatisht pasi që aty ka qenë interesi i shumëkujt. Prandaj në rastin konkret do të duhej të shikohet mundësia që ajo pjesë t'i jepej komunës dhe shtoi se ka mundësi të ndodh një gjë e tillë, sikur të ishte vullneti i mirë edhe i institucioneve qendrore. Në vazhdim tha se Grupi kuvendar i AAK-së nuk është kundër, por kërkojmë që të bëhen angazhime maksimale për kërkimin e kompensimit të pronës në fjalë, sepse kjo çështje nuk është vetëm përgjegjësi e kryetarit të komunës apo e institucioneve komunale që të sigurojë sipërfaqe për ndërtimin e gjykatës, pasi që është pushteti i katërt, që d.m.th se është i pavarur, por pasi që është në interesin e qytetarëve tanë, duhet ta përkrahim këtë kërkesë.

**Veli Karaça, anëtar i kuvendit-** tha se pajtohet që komuna ka nevojë për hapësira për institucionet lokale, por edhe institucionet qendrore janë tonat dhe është një shans për dy donacione ndërkombëtare, sepse është papërgjegjësi ta humbim këtë mundësi për ta themeluar një fakultet në komunën tonë. Po ashtu komuna jonë ka nevojë edhe për një objekt të ri të gjykatës, dhe shtoi se institucionet komunale duhet të kërkojnë kompensimin e këtyre parcelave. Në vazhdim tha se kërkesat në fjalë duhet të aprovohen, por mbetet obligim i kryetarit të komunës që në vazhdimësi të kërkojë kompensim për këtë pronë që po ua japim në shfrytëzim. Në fund tha se është mirë që gjykata ta ketë hyrjen nga rr. "Emin Duraku".

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar mosmarrëveshjes në mes të KGJK-së dhe Ministrisë së Drejtësisë, tha se parcela në stacionin e autobusëve është vend ideal, por është për keqardhje që këto dy institucione të larta nuk arrijnë

marrëveshje për interes të përbashkët, kurse na po bisedojmë me Serbinë për të bërë marrëveshje (edhe pse na kanë vrarë dhe na kanë grirë), dhe shtoi se nuk pajtohet që të merren vendime të ngutshme. Në fund tha se le të arrijnë marrëveshje Ministria e Drejtësisë me KGJK-në për t'u vendosur në atë pronë ndërtimi i objektit të gjykatës.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** propozoi që dy propozim-vendimeve në fjalë t'ju jepen parcelat në shfrytëzim afatgjatë prej 99 viteve, pasi që askush nuk i investon 2 milionë euro për një periudhë të shkurtë kohore, dhe shtoi se ndërtimi i fakultetit në Vushtrri është interes për të gjithë Kosovën.

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar dy propozim-vendimeve në fjalë, tha se nuk ka akt nënligjor që rregullon procedurat për dhënien në shfrytëzim për raste të veçanta, prandaj kërkoi nga kryesuesi i kuvendit të komunës se nëse aprovohen këto dy kërkesa të dërgohen urgjentisht në MAPL për vlerësimin e ligjshmërisë, për ta kuptuar se është bërë shkelje ligjore. Kurse te rasti i objektit të gjykatës, lidhur me shkresën e sjellur nga KGJK-ja tha se nuk mjafton vetëm shqyrtimi i mundësisë për dhënien e objektit aktual të gjykatës në përdorim Komunës së Vushtrrisë, por pasi që ata të marrin vendim që do t'i dorëzohet objekti i gjykatës Komunës së Vushtrrisë, atëherë edhe kuvendi i komunës do t'ua jap vendimin e aprovuar.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se është me rëndësi të veçantë që objekti i akademisë të ngrit në nivel të fakultetit, pasi që asnjë fakultet publik nuk e kemi në Komunën e Vushtrrisë, sepse përveç të mirave tjera krijon edhe mundësi për punësime të reja. Prandaj ftoj anëtarët e kuvendit që t'i aprovojnë kërkesat në fjalë për dhënien në shfrytëzim për 99 vite, kurse kërkesën e KGJK-së duhet kërkuar që objektin aktual të gjykatës t'ia japin si kompensim Komunës së Vushtrrisë, ndërsa akademja të mos kushtëzohet.

**Habib Mustafa, kryesues i kuvendit-** lidhur me kërkesën e I.Gashit, tha se çdo akt që aprovohet në kuvendin e komunës, brenda 7 ditëve dërgohet në MAPL për vlerësimin e ligjshmërisë.

**Idriz Muzaqi, udhëheqës i Zyrës Ligjore-** lidhur me dy propozim-vendimet në fjalë, propozoi që të kushtëzohen që nëse brenda afatit prej 2 apo 3 viteve nuk fillojnë investimet, atëherë të ndërpritet e drejta për shfrytëzim të atyre parcelave.

**Në fund të diskutimit lidhur me këto dy pika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 30 vota "për", 1 "kundër", 1 "abstenim" vendosi me sa vijon:**

**Për propozim-vendimin e parë:**

*Me këtë vendim jepet në shfrytëzim afatgjatë pjesë nga parcela P-70202016-02358-1, e cila evidentohet në certifikatën e pronësisë UL-70202016-00045, si dhe pjesë nga parcela P-70202016-02358-5 evidentuar në certifikatën pronësore UL-70202016-03596, ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, në sipërfaqe të përgjithshme prej: 00.40.00 ha.*

*Paluajtshmëria e cekur si në nenin 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin pa kompensim në afat prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) viteve, për Ministrinë e Punëve të Brendshme – Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, për ndërtimin e objektit të Fakultetit për Shkenca të Sigurisë Publike dhe konviktit të studentëve.*

*Nëse brenda afatit prej 3 (tre) viteve nga dita e miratimit nuk fillon investimi, atëherë ndërpritet (humbet) e drejta për shfrytëzimin e parcelës sipas nenit 1 të këtij vendimi.*

**Për propozim-vendimin e dytë:**

*Me këtë vendim jepet në shfrytëzim afatgjatë pjesa nga parcela nr. P-70202016-02358-1, e cila evidentohet në certifikatën e pronësisë UL-70202016-00045, ZK-Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, si dhe pjesa nga parcela P-70202016-*

**02358-5 e cila evidentohet në certifikatën e pronësisë nr. UL-70202016-3596 pronë e Komunës së Vushtrrisë e cila përfshin sipërfaqen e përgjithshme prej:00.15.00 ha.**

**Paluajtshmëria e cekur si në nenin 1 të këtij vendimi i jepet në shfrytëzimin Këshillit Gjyqësor të Kosovës për ndërtimin e Gjykatës Komunale të Vushtrrisë në afat prej 99 (nëntëdhjetë e nëntë) viteve, kurse Këshilli Gjyqësor i Kosovës obligohet që si kompensim për parcelën (e përmendur në nenin 1 të këtij vendimi) t'ia bart në pronësi Komunës së Vushtrrisë parcelën kadastrale dhe objektin aktual të Gjykatës Komunale në Vushtri.**

**Nëse brenda afatit prej 3 (tre) viteve nga dita e miratimit nuk fillon investimi, atëherë ndërpritet (humbet) e drejta për shfrytëzimin e parcelës sipas nenit 1 të këtij vendimi.**

**Pas aprovimit të dy vendimeve, e mori fjalën:**

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** sqaroi se votoi kundër që gjykata të vendoset aty ku ka bërë kërkesë për t'u vendosur, kurse kërkesa e akademisë policore është në rregull që u aprovua, pasi që lidhet me truallin ku gjendet academia policore.

#### **14. Shqyrtimi i Draft-rregullores për punën e kuvendit dhe organeve të tij (Shqyrtimi i dytë).**

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë tha se neni 6.6 është në kundërshtim me nenin 2, pasi që nuk figuron përkufizimi për zëvendëskryesuesin e Komitetit për Komunitete. Te neni 16.4, kërkoi që të shënohet "7 ditë pune para mbajtjes së mbledhjes së KK-së". Në fund lidhur me minutazhin e diskutimit kërkoi që të mos ketë 2 minuta diskutim, prandaj propozoi që diskutimi më i shkurtë të jetë 3, diskutimi i mesëm 5 minuta dhe diskutimi më i gjatë 10 minuta.

**Ferit Idriizi, anëtar i kuvendit-** lidhur me draft-rregulloren në fjalë paraqiti këto propozime: te neni 9, tha se nuk ka nevojë që neni pasues ta arsyetojë nenin paraprak, kur ka mundësi që drejtpërdrejt të sqarohet, dhe për nenin në fjalë propozoi këtë riformulim "mbledhja e jashtëzakonshme thirret me kërkesën e kryetarit të komunës ose me kërkesën e së paku 1/3 të anëtarëve të kuvendit"; te neni 13, kërkoi riformulim lidhur me ulëset, pasi që ulëset në kuvend ndahen duke u orientuar në anën e majtë, të djathtë dhe në qendër, varësisht nga profilimet politike që i kanë; te neni 13.4., propozoi këtë riformulim: "stafi i Sekretarisë së Kuvendit ulet në një vend të përshtatshëm, ku mund të shihen të gjithë anëtarët e kuvendit"; te neni 19.2., kërkoi që të mos ketë privilegje në minutazh të diskutimeve në mes të shefave të grupeve kuvendare dhe anëtarëve të kuvendit; te neni 24.2., tha se kanë të drejtë që anëtarët e kuvendit të kërkojnë pauza dhe të ndërprejnë seancën, prandaj e drejta e kërkesës duhet të jetë e pakufizuar.

**Veli Karaça, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të LDK-së, paraqiti këto propozime: te neni 18.2, propozoi që fjala "të nevojshme" të zëvendësohet me fjalën "urgjente"; te neni 24.3, propozoi të shtohet fjalia "apo për ndërprerje"; te neni 25.6 të korrigjohet një gabim teknik në vend të paragrafit 26.5 duhet të jetë 25.5; te neni 26 propozoi një aline të re me këtë përmbajtje: "procesverbali arkivohet dhe ruhet konform dispozitave ligjore"; te neni 31.2, propozoi që fjalia "kryetarin e komunës" të zëvendësohet me fjalinë "grupet kuvendare të komunës".

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** lidhur me draft-rregulloren në fjalë paraqiti këto propozime: nga neni 27.1 propozoi të hiqet fjalia "duke mos i respektuar urdhërat e kryesuesit", kurse në po të njëjtin paragraf të hiqet fjala "duhet"; te nënparagrafi 27.1.1., propozoi që fjala "urdhëron" të zëvendësohet me fjalën "kërkon".

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** te neni 6.6 sqaroi se nuk është fjala për zëvendëskryesuesin e kuvendit, por është fjala për zëvendëskryesuesin e Komitetit për Komunitete.

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar neni 13.1 të draft-rregullores në fjalë, propozoi këtë formulim: “anëtarët e kuvendit sipas subjektit politik që i përkasin ulen në ulëset të cilat janë të përcaktuara si rezultat i marrëveshjes së kryesuesve të grupeve kuvendare dhe kryesuesit të kuvendit të komunës, duke i dhënë përparësi në zgjedhje subjektit që ka fituar më së shumti vota”.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

***Aprovohet rregullorja në fjalë duke inkorporuar vërejtjet dhe propozimet e anëtarëve të kuvendit.***

**15. Të ndryshme:**

**a. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale (Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale).**

**b. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale (Drejtoria për Buxhet dhe Financa).**

**Në fund të diskutimit lidhur me këto dy pika të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**Për propozim-vendimin e parë:**

***Me këtë vendim ndryshohet Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale 01Nr.330/12, dt. 27.12.2012, si në vijim: hiqen tarifat e nivelit dytësor të përcaktuara nga pika 1.42 deri 1.86 e rregullores në fjalë.***

**Për propozim-vendimin e dytë:**

***Me këtë vendim ndryshohet Rregullorja për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale 01Nr.330/12, dt. 27.12.2012, si në vijim: hiqet paragrafi 7.5 i nenit 7 të rregullores në fjalë.***

**c. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave për studentë për vitin shkollor 2012/2013.**

**Habib Mustafa, kryesuesi i kuvendit-** tha se në marrëveshje me shefat e grupeve kuvendare jemi dakorduar që komisioni në fjalë t'i ketë 5 anëtarë me këtë përbërje: drejtori i Drejtorisë për Arsim, 2 anëtarë nga PDK-ja, 1 anëtar nga LDK-ja dhe 1 anëtar nga AAK-ja.

**Ferit Idrizi, anëtar i kuvendit-** sugjeroi që këto praktika të mos përsëriten edhe pse kanë qenë në të kaluarën, sepse dalngadalë kuvendi i komunës është duke i marrë kompetencat e ekzekutivit dhe po stërngarkohen mbledhjet.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** Grupi kuvendar i LDK-së propozon Vlora Qirezin për anëtare të komisionit në fjalë.

**Naile Osmani, anëtare e kuvendit-** në emër të Grupit kuvendar të PDK-së propozoi Selim Rustemin për anëtar të komisionit në fjalë.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit-** nga PDK-ja propozoi Habibe Gërzhaliun për anëtare të komisionit në fjalë.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-** shprehu mospajtimin e saj me diskutimin e F.Idrizit lidhur me pjesëmarrjen e anëtarëve të kuvendit në komisionin në fjalë, duke shtuar se Grupi kuvendar i AAK-së mendon se fuqizimi i demokracisë është përfshirja masovike në vendimmarrje, kurse nga AAK-ja propozoi Qazim Azemin për anëtar të komisionit në fjalë.



**Ferit Idrizi, anëtar i kuvendit-** sqaroi se nuk e kishte qëllimin për të mos u përfshirë grupet kuvendare, por kërkoi që të mos jetë fare komision i kuvendit, sepse kuvendi i komunës e ka në kompetencë aprovimin e buxhetit, kurse për veprimet e mëtutjeshme ekzekutivi do të raportojë në kuvend.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**Me këtë vendim formohet komisioni prej 5 (pesë) anëtarëve për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës për vitin shkollor 2012/2013, në këtë përbërje:**

1. **Qerim Selimi, drejtor i Drejtorisë për Arsim;**
2. **Selim Rrustemi, anëtar i kuvendit (PDK);**
3. **Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit (PDK);**
4. **Vlora Qirezi, anëtare e kuvendit (LDK);**
5. **Qazim Azemi, anëtar i kuvendit (AAK).**

**ç. Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.**

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar vendimit të aprovuar nën "a" në "të ndryshme" shprehu mospajtimin e tij me atë që ka vendosur komisioni i përbashkët i MAPL-së dhe Ministrisë së Financave, të cilët kanë thënë se komuna nuk ka të drejtë të vendosë tarifa dytësore, mirëpo tarifat që janë vendosur në rregullore nuk kanë qenë dytësore, por titulli në rregullore ka qenë i gabuar, sepse QKMF-ja nuk ofron shërbime dytësore, por ofron shërbime primare për qytetarët.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** kërkoi për mbledhjen e radhës së KK-së të përgatitet një informatë mbi gjendjen e punëve në fabrikën e ujit, në mënyrë që të kuptohet se deri ku kanë shkuar punimet.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** kërkoi për mbledhjen e radhës së KK-së të përgatitet një informatë për masat që janë ndërmarre, pasi që para disa ditëve nga përlëshjet e një grupi të gangsterëve ka pasur edhe të vvarë, por ajo që është shqetësuese (në bazë të informatave nga shërbyesit civil) dy ditë më parë njëri prej këtyre gangsterëve ka ardhur në komunë për ta marrë një vërtetim me revole të ekspozuar, për këtë arsye kërkoi që të ndërmerren masa, pasi që po rrezikohen edhe shërbyesit civil, prandaj pyeti se çka po ndërmerren policia dhe kryetari i komunës për t'u mbrojtur jeta e qytetarëve nga këto grupe gangsterësh. Pastaj kërkoi nga kryetari i komunës që të marrë iniciativë për hartimin e një rregulloreje për iniciativë qytetare për pastërtinë e ambientit, dhe shtoi se ka shembuj te shtetet e Bashkimit Evropian, ku çdo lagje ka një iniciativë qytetare për pastimin e ambienteve aty ku jetojnë. Në fund kërkoi informatë me shkrim nga kryetari i komunës se deri ku kanë arritur punët e ndërtimit të objektit të ri të komunës, pasi që momentalisht punët janë ndërprerë.

**Selvetë Sholla, anëtare e kuvendit-** paraqiti problemin e faturës në tatimin në pronë, ku në vitin 2008 e ka njoftuar bordin e drejtorëve se nuk posedon banesë dhe pasi që më është aprovuar kërkesa dhe është çregjistruar banesa, për të njëjtën banesë figuron se e ka blerë në vitin 2010 dhe për këtë i vijnë faturat, por në të vërtetë nuk kam fare banesë, prandaj kërkoi që t'i çregjistrohet kjo banesë.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** në emër të banorëve të fshatit Pestovë paraqiti kërkesë për Drejtorinë për Shërbime Publike dhe për kryetarin e komunës për sigurimin e një parcele për varreza, duke shtuar se në fshatin në fjalë është një pronë komunale.

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** kërkoi informatë nga drejtorja përkatëse dhe nga kryetari i komunës se a janë kryer punimet në miniparkun që gjendet te banesat e bardha, si dhe a janë kontrolluar punimet pasi që gjendja faktike është e keqe, duke shtuar se pranë atij miniparku përveç mbeturinave të shumta ka edhe kafshë të ngordhura, dhe për këtë arsye kërkoi mirëmbajtjen e miniparkut. Pastaj kërkoi nga

drejtoria përkatëse dhe nga kryetari i komunës t'i kushtohet rëndësi e madhe gjelbërimit dhe pastërtisë së qytetit.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** tha se në rrugën "Dëshmorët e Kombit" janë duke u kryer punime, por nuk ka ndonjë pllakë në hyrje të rrugës ku fillojnë punimet e cila do të tregojë se kur kanë filluar punimet dhe deri kur do të zgjasin, pasi që në këtë rrugë ka biznese dhe njerëz me nevoja të ndryshme, prandaj ata kanë nevojë t'i kenë këto informacione. Pastaj tha se për ndërtimin në objektin e ri të komunës, si dhe për punimet në ndërtimin e fabrikës së ujit është në pajtim të plotë me transparencën që kryetari i komunës ta informon kuvendin e komunës për realizimin e projekteve, dhe nëse ka ngecje edhe për ngecjet, sepse në bazë të pllakës së vendosur objekti i ri i komunës është dashtë të jetë i përfunduar qe dy muaj. Mandej tha se njëra ndër çështjet me rëndësi për qytetarët është mirëmbajtja e rrugëve, sepse ka shumë rrugë me gropa, prandaj kërkoi mirëmbajtjen e rrugëve, duke i mbyllur edhe gropat.


**Sabri Ferati, anëtar i kuvendit-** kërkoi informatë për mbledhjen e ardhshme të KK-së lidhur me masat e ndërmarra për vaksinimin e kafshëve në komunën tonë, pasi që në të kaluarën ka pasur raste të sëmundjeve të rënda të shtazëve.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** duke iu referuar pyetjeve të anëtarëve të kuvendit, u përgjigj me sa vijon: zyrtarët e sekretarisë dhe ata të zyrës ligjore të konsultohen me përfaqësuesit e MAPL-së rreth atyre piakve, në mënyrë që të bëhet një rregullore siç duhet; fabrika e ujit ka qenë projekt 3 vjeçar, dhe ka bërë presion të madh për t'u kryer në fund të muajit qershor, në mënyrë që gjatë verës të ketë ujë të mjaftueshëm, dhe shtoi se është duke u punuar me një dinamikë të madhe, prandaj sipas inxhinierëve mbikëqyrës të kompanisë shumë shpejt do të përfundojnë punët e vrazhda dhe sipas tyre gjithçka do të përfundojë në këtë vit; dy vrasjet brenda një dite kanë qenë tragjedi e vërtetë dhe shtoi se ka raste kur në objektin e komunës vijnë njerëz që dëshirojnë të demonstrojnë forcën e tyre, ku është detyruar për ta kërkuar intervenimin e policisë për largimin e tyre, po ashtu shprehu pakënaqësinë e tij me punën e policisë, pasi që është krijuar një kaos në komunikacion; ndërtimi i objektit të ri të komunës është projekt i Komisionit Evropian, por projekti nuk po zhvillohet pasi që ka një konflikt në mes të Komisionit Evropian dhe kompanisë që është duke i kryer punimet, dhe premtoi se së shpejti do t'i drejtohet me shkrim Komisionit Evropian për të përfunduar punimet për objektin e ri të komunës; kërkesën për lokacion të varrezave në fshatin Pestovë duhet bërë me shkrim, por për të ardhmen propozoi shqyrtimin e mundësisë që fshatrat përreth Vushtrisë t'i kenë varrezat e përbashkëta me qytetin; për punimet në miniparkun të banesat e bardha shprehu pakënaqësinë e tij, duke shtuar se ka kërkuar edhe disa objekte që janë vendosur dhe disa kiosqe të largohen, pasi që po e prishin pamjen në atë pjesë; për riparimin e gjelbërimit është duke u zhvilluar projekti, dhe shtoi se gjendja e fidaneve është relativisht e mirë; projekti në rrugën "Dëshmorët e Kombit" është 3 vjeçar; për mirëmbajtjen e rrugëve njoftoi se në këtë vit është bërë një kontratë-kornizë me një kompani në afat 2 vjeçar, ku për çdo dëmtim të rrugëve, menjëherë do të intervenohet, prandaj shumë shpejt do të rregullohet çështja e gropave nëpër rrugë.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** tha se kryetari i komunës duhet të merr masa, pasi që inspeksioni nuk është duke e kryer punën siç duhet, pasi që në shumë vende ka mall që shitet në rrugë (trotuare).

**Mbledhja përfundoi në orën 11:45.**

**Procesmbajtësi**

  
**Alban Tahiraj**

**Kryesuesi i Kuvendit**

  
**Habib Mustafa**

